



Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKË
PROCUREMENT REVIEW BODY



AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit KK Prishtinë OE ankues: "Ndriqimi" OE ankues: "Risamont"	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Ilir Halili - Ekspert profesional shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesatme : Nr.305/19 të parashtruar nga OE "Ndriqimi" –Prishtinë, Nr.317/19 të parashtruar nga OE:"Risamont"-Prishtinë		
Datë	01.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, junjorëve me raportin, lidhur me ankesën e datës: 12.06.2019, me nr.305/19 të parashtruar nga OE "Ndriqimi"-Prishtinë, si dhe ankesën e datës 14.06.2019 me nr.317/19 të parashtruar nga OE:"Risamont"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik", me numër të prokurimit: 616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:


- Autoriteti Kontraktues – **KK Prishtinë**
- Paneli Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"Ndriqimi"- Prishtinë.**
- OE ankues – **"Risamont" - Prishtinë.**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Ndriqimi"-Prishtinë, dhe ankesën e parashtruar nga OE:"Risamont"-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik", me numër të prokurimit: 616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.



Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		17.06.2019	01.07.2019
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>		<i>data e autorizimit të ekspertit.</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën:12.06.2019OE"Ndriqimi"-Prishtinë,ka parashtruar ankesë në OSHP, me nr.305/19, ndërsa me datë 14.06.2019 OE:"Risamont" ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.317/19,kundërnjoftimit përdhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik", me numër të prokurimit:616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–KK Prishtinë.

Konform nenit113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Dispozitat e shkelura sipas Operatori Ekonomik ankues"Ndriqimi"-Prishtinë

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Rregullorja për çmime jonormalisht të ulëta

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Ndriqimi"-Prishtinë, dhe ankesën e parashtruar nga OE:"Risamont"-Prishtinëlidhur me aktivitetin e prokurimit"Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik", me numër të prokurimit:616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

Të nderuar, autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar me dt:30.05.2019, ku na ka eliminuar me arsyetimin se në asnjërin prej pozicioneve që kanë kërkuar sqarime nuk i kemi arsyetuar në mënyrë të provuar në aspektin faktik.

Të nderuar, AK-ja në FDT tek neni 30.1 ka përcaktuar kriterin për dhënie të kontratës si në vijim "Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët i poentuar".

Na bazë të këtij kriteri edhe autoriteti kontraktues kur i ka poentuar çmimet e ofruar ka rezultuar se ne jemi me çmim më të ulët me poentim, duke u renditur i pari me 62 poena, prandaj ne është dashur të shpallemi fitues i këtij tenderi.

AK-ja dt:27.05.2019 ka kërkuar nga ne sqarime për pozicionet 2, 10, 23, 35, 44, 45, ndërsa ne me dt:29.05.2019 iu kemi kthyer sqarimet shtesëku i kemikonfirmuar se ne i kemi të gjitha kapacitetet dhe mund ti bëjmë furnizimet dhetikryejm me përgjegjësipunët që janë të përcaktuara në këto pozicione. Për pozicionin nr. 2 ju kemi treguar se ne në depon tonë kemi një sasi të caktuar të trupave ndriçues Led 100W, ndërsa sa i përket pozicioneve 10,23, 35, 45, ju kemi sqaruar se anëtar i konsorciumit tonë "NTSH Inline Engineering është distributor i kabllave energjetike nga prodhuesi Turkis dhe ka garantuar se do të liferon këto pavarësisht çmimeve.

Sa i përket pozicionit Nr. 44, ne iu kemi sqaruar se për këtë pozicion ne e posedojmë instrumentin tone dhe nuk kemi diçka të veçantë të shpenzojmë për këtë pozicion.

Të nderuar, autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit të ofertës tonë iu ka referuar nenit 61 të LPP-së, edhe pse kjo dispozitë nuk flet për çmime jo normalisht të ulëta për pozicione.

Autoriteti kontraktues nuk i ka zbatuar dispozitat e parashikuara tek rregullorja për çmime jo normalisht të ulëta, dhe nuk e ka zbatuar procedurën siç parashihet në tabelën e dhënë të kjo rregullore për të përcaktuar se cila ofertë është me çmim jo normalisht të ulët.

Pashtu AK-ja e ka favorizuar OE të rekomanduar për kontratë, pasi që ky operator ekonomik në shumë pozicione ka çmime jashtëzakonisht të ulëta dhe që nuk janë çmime të tregut, si p.sh:

pozicioni nr.6- Porosia, furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit lineare 9m. Është ofruar çmimi prej 1.00 €, ndërsa çmimi i tregut është përafërsisht 80 euro, tek pozicioni nr.17- Porosia dhe montimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndriçimit publik, me pjesën e gjatit shtesë nga jashtë për leximin e njehsorit, pjesën e zbrazur rezerve të mbrojtur me dim (120.x90x30).

-Njehësorë elektrikë 3x230/400V	1
- Ndërprerës AS-/A	1
-Transformatorë rrymorë /5 A	6
- Mikrondërprerës /A	1
- Portllampë E27	1

- Poç fluroshent 1 x 18ë me baze 1	
-PrizëOG16A	1
- Voltmetër Vm 0-500 V	1
- Ampermetër Am 0-200A	1
- Ndërp. Zgjedhës për Am80A-u-R10 1	
- Ndërprerës tipi GS-16-66U	1
- Sig. Tripolare automatike /A te vendosura ne kuti per 3 siguresa complete 3 ORS siguresa 9 patron /A	
-Siguresa njëpolare automatike 10-16A 6 copë schneider	
- Përçues 1x25 mm 2 (m)	50
- Ndërprerësi automatik/A	1

Tek ky pozicion OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim prej 1.00 €, ndërsa në treg mund të gjendet përafërsisht me 450 euro.

Tek pozicioni nr.18- Fumizimi, transporti dhe montimi i relesë Astrologjike IC Astro-Siemens,Shnaider,Abb ose e ngjashme, ka ofruar çmim prej;0.10 cent, ndërsa në treg gjendet përafërsisht 70 euro.

Tek pozicioni Nr.24- Fumizimi, transporti dhe montimi i shtyllës ndriqese të zingtuar konike që realizohet me mbjellje me lartësi $H = 7.8m$ me pjesë redukuese në shtyllë duke përfshirë, kapakun, kabëll lidhëse ($3 \times 2.50mm^2$) dhe materialit tjetër të nevojshëm.Komplet me standarde ISO. UNI EN ISO 1461 standardi i zingtimit, ka ofruar çmim prej 1.00 €, ndërsa çmimi i tregut është përafërsisht 115 euro.

Tek pozicioni Nr.28- Fumizimi,transporti dhe montimi i shtyllës ndriqese të zingtuar konike që realizohet me mbjellje me lartësi $H = 5.5m$ me pjesë redukuese në shtyllë duke përfshirë , kapakun, kabëll lidhëse ($3 \times 2.50mm^2$) dhe materialit tjetër të nevojshëm.Komplet me standarde ISO. UNI EN ISO 1461 standardi i zingtimit, ka ofruar çmim prej 1.00 €, ndërsa çmimi i tregut është përafërsisht 90 euro etj.

Gjithashtu edhe në shumë e shumë pozicione OE i rekomanduar për kontratë ka çmime jonormalisht të ulëta.

-Sa i përket sqarimeve që ne ju kemi dhënë me dt:29.05.2019, ne ju rikujtojmë se pozicioni Nr. 23 dhe pozicioni Nr. 35 shkojnë bashkërisht me pozicionin Nr. 37 dhe pozicionin Nr. 46. Pozicioni Nr. 37 është shiriti vrojtues dhe pozicioni Nr. 46 është gypi bronzun 0 63. Sa sasi që shpenzohet në kabëll duhet të shpenzohet edhe shiriti vrojtues edhe gypi i bronzuar.

Sa i përket pozicionit Nr. 44, ne iu kemi sqaruar se për këtë pozicion ne e posedojmë

instrumentin tone dhe nuk kemi diçka të veçantë të shpenzojmë për këtë pozicion.

Autoriteti kontraktues në vendimin e tyre të dt:05.06.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim ndër të tjera arsyetohet se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë është më i ulët në krahasim me ofertat tjera, ndërsa ne jemi me çmim i treti. Autoriteti kontraktues bie në kundërshtim me vendimet dhe veprimet e tyre, sepse si ka mundësi që OE i rekomanduar për kontratë të jetë me çmim më të ulët se ne, e ky operator ekonomik ti ketë çmimet e tregut dhe normale, e ne ti kemi çmimet jonormalisht të ulëta. Kjo është një absurditet i vlerësimit.

AK-ja në vendimin e tyre poashtu e cek se ka përdorë formulën e poentimit për pozicionet që kanë poentim më të lartë dhe se vetëm në një pozicion OE i rekomanduar për kontratë ka rezultuar me çmim jonormalisht të ulët, ndërsa OE ankues në 6 pozicione.

Autoriteti kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta duke përdor formulën vetëm në 6 pozicionet ku OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime më të larta se ne. Në dispozitat e LPP-së, askund nuk shkruan se formula duhet të përdoret në këtë mënyrë, e ku i përshtatet autoritetit kontraktues por formula duhet të përdoret në mënyrë jo diskriminuese dhe siç parashihet me dispozita të LPP-së.

Nëse do të përdorej formula në pozicione tjera atëherë OE i rekomanduar për kontratë do

të rezultonte se ka në shumë e shumë pozicione tjera çmime jo normalisht të ulëta. Sa për ilustrim, ju sqarojmë se prej 51 pozicioneve që janë gjithsejtë, në 32 pozicione OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime prej 0.10 cent e më pak, kurse OE ankues ka ofruar çmime të tilla në vetëm 17 pozicione.

Pra po të analizohej në detaje oferta e OE të rekomanduar për kontratë, rezulton se ky OE ka ofruar në shumë pozicione çmime jonormalisht të ulëta dhe manipulative, prandaj po të përdorej formula dhe të krahasohej me pozicionet ku OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime më të ulëta (jonormalisht të ulëta) ndërsa ne ku kemi ofruar çmime më të larta atëherë do të rezultonte se OE i rekomanduar për kontratë nuk mund të jetë fitues i këtij tenderi në asnjë mënyrë dhe rrethanë.

Sa i përket arsyetimit të AK-së, se për pozicione më të rëndësishme është përdor formula, ne ju sqarojmë se secili pozicion e ka rëndësinë e vet dhe përderisa janë parashikuar këto pozicione në dosje të tenderit, atëherë janë të vlefshme dhe janë të ndërlidhura njëra me tjetren këto pozicione dhe natyrisht janë të pandashme.

Përfundimisht autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, sepse na ka eliminuar neve si kompani edhe pse me poentim jemi renditur i pari duke e plotësuar edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët me poentim.

Gjithashtu nuk janë respektuar edhe procedurat për çmime jonormalisht të ulëta siç parashihen në rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta, duke mos e përdorur tabelën dhe më pastaj procedurën inter partes.

Me këtë vlerësim dhe vendim na kanë diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP -së dhe njëkohësisht është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, i cili është renditur i treti me renditje me çmim të poentuar.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja, që të merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e OE "Ndriqimi" si e bazuar, dhe lënda të kthehet në RTVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Dëmet Materiale

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 20,000.00 euro.

Shënim: Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar nga OE ankuese në OSHP, janë të njëjta me ato të paraqitura me kërkesën për rishqyrtim nga OE ankues në AK.

Dispozitat e shkelura sipas Operatori Ekonomik ankues "Risamont"-Prishtinë

1. **KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË DHE TË KUALIFIKIMIT**
Neni 64 Dëshmitë e kërkesave
2. **Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve**
3. **Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale**
4. **Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**
5. **Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë**
6. **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
7. **Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
9. **Neni 61 Tëndërçet Jo Normalisht të Ulët**
10. **Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës**
11. **Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes**
12. **Neni 28 Specifikimet teknike**
13. **Neni 7 Barazianë Trajtim/Jo-Diskriminimi**

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Ndriqimi" -Prishtinë, dhe ankesën e parashtruar nga OE: "Risamont"-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik", me numër të prokurimit: 616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.



12. Neni 28 Specifikimet teknike
13. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

*** Sipas Nenis 118 të LP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një globë shesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrëshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtuani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me dt.31.05.2019 në ora 08:30kemi pas qasje të pakufizuar në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke ju referuar raportit të vlerësimit nga ana e AK dhe Kriterëve të përgjydhjes së OE të propozuar për kontratë konform kërkesave të AK të dhëna/kërkua në FDT(Fleta e Te Dhenave Te Tenderit), atëher ne po e analizojmë tërë ecurinë e procesit si dhe mangësit apo shkeljet e evidentuara



• LISTA E PLOTË E STANDARDEVE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Nga raporti i vlerësimit del që edhe OE i propozuar për kontratë i plotëson kriteret e përcaktuara nga ana e AK.

Të gjeturat, faktet dhe argumentet:

Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare	Faktet dhe argumentet e gjetura
<p>1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, me vlera minimale prej 300.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit 2016-2017-2018 (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë).</p>	<p>1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfutjesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.</p>	<p>1. Aneksi 6 nuk është plotësuar fare nga ana e OE të propozuar për kontratë ashtu siç është kërkuar nga (Kusht Administrativ), mirëpo është dorëzuar një fo tëjetër e formular dhe plotësuar nga ana e vet OE. N FDT ky dokument është kërkuar si dëshmi dokumen nërsa te ANEKS 6 është shkruar: Aneksi 6. Lista e kontratave të realizuara ne 3 vitet e fundit (2017-18)</p> <p>(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)</p>
		<p>2. Vlera e punëve të kryera të natyrës së njëjtë brenda periudhës trevjegare (2016-2017-2018) e dokument me raporte të pranimeve apo referenca nuk plotëso nga ana e OE të propozuar për kontratë. Përveç kësaj gjat analizës që ju kemi bërë dokumenteve të dorëz kemi hasur në dokumente të falsifikuara.</p>

2	Vendosja e ndriçimit publik në Fushë Kosovë dhe Kuzmin	6121868995 21	KK Fushë Kosovë	23.10.20 18	21.12.20 18	31,657.9 0 €	00 €	Raporti i pranimit të punëve nuk disponon numrin e prokurimit, kështu që nevojitet të verifikohet raporti i pranimit. Forma e këtij raporti pa vule dhe pa ndonjë element që e verifikon origjinalitetin e tij. Gjenden dy raporte të të njejtes datë(kontratrat me Nr.rend 1 me Nr.rend2)..
	Ndriçimi publik në fshatin Ruboc	KM653-18- 6068-5-3-6	KK Kamenicë	13.09.20 18	16.11.20 18	4,817.90 €	4,817.90 €	PO
3								



							Kontrata eshte nenshkruar dhe protokoluar me dt.13.08.2018. Kontrata eshte dyvjeqare, ndërsa referencia eshte leshuar me dt.03.05.2019 ku shkruan se koha e realizimit te kontrates eshte 27.03.2015-25.03.2017. duke ju referuar kontratës së lidhur me 13.08.2018 dhe me kohëzgjatje dyvjeqare, atëher del qe kjo kontratë është në realizim e sipër dhe se referencia është e falsifikuar apo KK Kamenicë ka lëshuar referencë në mënyrë të jashtëligjshme. Mirëpo duke pas parasysh që data e references është data e dorëzimit të tenderit, atëher gjasat më reale janë se referencia është falsifikuar. Kjo kontratë në listen e kontratave të evidentuara, data e përfundimit të projektit është shkruar data: 03.05.2019 gje që faktotet falsifikimi i këtij dokumenti
4	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Kamenicës	KM653-18-3445-2-2-1	KK Kamenicë	13.08.2018	03.05.2019	39,000.00 €	0.00 €



zyrtar dhe kontraverz.

[Signature]

		Në pjesën e poshtme po e japim listën e kontratave, datën e fillimit/përfundimit, punëdhënsin si dhe statusin e kontratës në raport me raportin e pranimit apo referencës për punën e kryer:	
--	--	--	--

Nr.rend. d.	Kontrata	Nr.Prokurimi t	Punëdhën si	Fillimi	Përfundimi	Vlera e kontratës	Vlera e punëve të përfunduara/Pranu ara	Raporti i pranimit/referenca dhe të gjeturat e faktuara
1	Vendosja e ndriçimit publik në Fushë Kosovë	6121884345 21	KK Fushë Kosovë	04.12.20 18	21.12.20 18	12,172.4 0 €	00 €	Raporti i pranimit të punëve nuk disponon numrin e prokurimit, kështu që nevojitet të verifikohet raporti i pranimit. Forma e këtij raporti pa vule dhe pa ndonjë element që e verteton origjinalitetin e tij. Gjenden dy raporte të të njëtës date (kontratat me Nr.rend 1 me Nr.rend2).



	Vendosja e ndriçimit publik Faza e dytë	612 17 4174 521	KK Fushë Kosovë	17.10.2017	17.08.2018	36,231.90 €	0.00 €	Referenca e lëshuar nga KK Fushë Kosovë bartë tjetër numër të prokurimit nga aji i përshkruar në kontratë. Numri i prokurimit në kontratë: 612 14 4174 521 dhe i brendshëm 612 17 074 521. Numri i prokurimit në referencë: 612 17 054 521. Numri i protokollit në kontratë është i përmirësuar. Kjo reference nuk është e vlefshme apo mundë të jetë e falsifikuar. Duhet të verifikohet
	Ndriçimi publik në rrugën Babush-Gadime e Epërme	613-017-079-521	KK Lipjan	12.09.2017	21.12.2017	39,048.30 €	39,048.30 €	PO
	Furnizimi, instalime elektrike							Duhet të verifikohet transaksioni bankarë pasi që kemi të bëjmë me sektor privat ku kontratat dhe referencat mundë të mos jenë të vlefshme apo të vërteta.
7	ne objektin afarist në Çagllavicë		ELTRISI sh.p.k.	14.07.2019	01.11.2018	11,850.32 €	0.00 €	



8	Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra	613-016-086-221	KK Lipjan	24.11.2016	20.02.2018	28,927.00 €	28,927.00 €	PO. Kontrata ka qenë për periudhën kohore 24.11.2016-24.11.2019. Duhet të verifikohet kur është përfunduar kontrata.
9	Rikonstruimi i ndriçimit publik në qytet dhe fshatra e Prishtinës-Faza III	NR616-16-026-521	KK Prishtinë	11.11.2016	20.02.2018	77,321.00 €	77,321.00 €	PO
10	Mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët e Prishtinës-Faza e I	616-16026-521	KK Prishtinë	13.05.2016	20.02.2018	28,487.00 €	28,487.00 €	PO

	Zgjerimi i ndriçimit publik në fshatrat dhe qytetin e Komunës së Prishtinës	616-15-036-521	KK Prishtinë	03.07.2015	190,487.85 €	0.00 €	Projekti kryesorë është i një kompanie tjetër, ndërsa MVR sipas një kontrate është punëkryes i një pjese të këtij projekti. Duhet të verifikohet vlera e punëve të kryera me transaksione bankare. Sipas kontratës baze projekti është brenda vitit 2015, kështu që nuk është kontratë e vlefshme, pasi që kontratat e kërkuara duhet të jenë brenda tre viteve të fundit (2016-2017-2018).
11	Mirëmbajtja elektrike në shkollë	616-15-098-221	KK Prishtinë	28.10.2015	09.03.2016	31,911.01 €	PO
12	Mirëmbajtja e ndriçimit publik në komunën e Lipjanit	18163-015-003-221	KK Lipjan	24.08.2015	05.12.2016	20,870.00 €	Kontrata është pa çmime, ndërsa referenca i referohet punëve të kryera në vlerë 20870EUR. Duhet të verifikohet vertetësi e referencës dhe kontratës. Numri i prokurimit në kontratë shifër se është i manipuluar.
13							

14	Furnizimi, transporti, montimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e ndërcimit publik ne qytet dhe Fshatra	653-15-012-221	KK Kamenicë	02.09.2015	24.08.2016	25,000.00 €	0.00 €	Sipas kontratës dhe refernces, kjo kontratë ka gene per vitin 2015, gje qe nuk është e vlefshme për këtë aktivitet të prokurimit pasi që kërkohen kontratat me referencia nga viti 2016-2017-2018.
				Totali i evidentuar		577,782.58 €	210,512.21 €	
				Vlera reale e dokumentuar e puneve te kryera		210,512.21 €		

Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare	Faktet dhe argumentet e gjetura:
1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, me vlerë minimale prej 300.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit 2016-2017-2018 (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë).	1. Një listë të kontratave të realizuara, duke përfshirë Anësin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e	Faktet dhe argumentet e gjetura: Duke ju referuar fakteve dhe argumenteve të gjetura më lartë, atëherë përveç që nuk plotësohen kërkesa e AK (Kusht Administrativ), gjithashtu dokumentet e dorëzuara: kontratat, raportet, referencat dhe dokumentacioni tjetër që ndërridhet me kërkesën e AK, janë dyshimta me elemente të falsifikimit dhe mashtrimit.

	kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfutjesin, si dhe listën bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.	
Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare	Faktet dhe argumentet e gjetura:
<p>2. Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme</p> <p>a) Një inxhinier të Elektroteknikës - me përvojë 3 vjeçare pas diplomimit. b) 10 (dhjetë) punëtor me përvojë në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit për ndriçimin publik</p>	<p>2. CV-2, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt (inxhinierin e elektroteknikës). Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt për (10 punëtorët).</p>	<p>Lista e stafit e dorëzuar ka gjithsej dhjetë punëtor dhe një inxhinier i diplomuar.</p> <p>Sipas kërkesës së AK duhet të jenë dhjetë punëtorë profesional për ndriçime, ndërsa OE i ka: katër teknik të elektros, katër punëtor fizik dhe dy shofer.</p> <p>Nga kjo shifër që kërkesa e AK nuk plotësohet për 10 (dhjetë) punëtor me përvojë në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit për ndriçimin publik.</p> <p>Përvoja e stafit nuk është e evidentuar askund.</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare	Faktet dhe argumentet e gjetura:
<p>3. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilitmentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe</p>	<p>3. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për</p>	<p>Faktet dhe argumentet e gjetura:</p> <p>Per eskavatore nuk ka dëshmi të argumentuara</p>

mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. a) 2 (dy) Kamion me SHPORTA b) 1 (një) Kamion me Vinç c) 1 (një) Eskavator		autonjëtet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për autonjëtet që regjistrohen për vitin 2019. Në rastet kur OE ka marrveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzoj edhe marrveshjen për shfrytëzim.	
Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare	Faktet dhe argumentet e gjetura:	
5. Operatori Ekonomik duhet ta sjell KATALOGUN për shtylla dhe drita	Katalogu duhet të jetë original	Duke pas parasysh se janë kërkuar katalogjet për shtylla dhe drita, ndërsa OE i propozuar për kontratë nuk ka sjell fare katalog për shtylla (përveç katalog për drita she shtylla të metalta) të betonit për ndricimim ashtu siç janë kërkuar në paramas dhe parallogari si dhe të dokumentuara me katalog sipas kërkesave të përshkruara në FDT Kapaciteti teknik dhe profesional. <u>Kusht administrativ.</u>	
ANALIZA E ÇMIMEVE			
TENDERUESI	Arsyet për refuzim të tenderit për shkak të çmimeve abnormalisht të ulëta	TË GJETURAT NGA QASJA NË DOKUMENTE	
Grupi I Operatorve ekonomik N.S.H.	Asnjë pyetje nuk i	Pasi që kemi pas qasje në dokumente të OE të propozuar	

M.V.R.ELEKTROMONTUES, Delta-Ing SH.P.K.	është bërë OE, të paktën nuk janë të evidentuara në raportin e vlerësimit!	<p>për kontratë, atëher kemi qenë të befashuar se si AK në raportin e vlerësimit nuk e ka pa të arsyeshme të bëj pyetje sqaruese fare për OE të propozuar për kontratë!?</p> <p>Pas analizës që i kemi bërë paramases dhe parallogarisë së OE të propozuar për kontratë, atëher po i qesim në pah edhe këto detale apo vrejtye të pa trajtuara apo të paevidentuara nga komisioni i vlerësimit, pra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nga 51 (pesëdhjet e një) pozicione sa l ka params dhe parallogaria, 33 (tridhjet e tre) pozicione janë me çmim 0.1cent, apo në përqindje 64.7% të pozicioneve janë me çmim 0.1cent. Ndërsa në raport me rëndësin e pozicioneve dhe çmimeve për pozicione, del që 85% e pozicioneve jo që janë jo-normalisht të ulëta, mirëpo janë ekstremisht të ulëta që asnjë ekonomi e procesit nuk mundë ta arsyetojë këtë. 2. Pasi që e kemi pyet zyrtarin e AK se a keni pas ndonjë komunikim me OE të propozuar për kontratë në lidhje me çmimet jo-normalisht të ulëta, përgjigja ishte se i kan sqaruar dy pozicione (edhe pse ato nuk janë pjesë e raportit të vlerësimit). Këto dy pozicione i kemi identifikuar nga përgjigja e OE që l ka dërguar AK-së pasi që pyetjet e AK-së nuk i kemi par fare. <p>Pozicionet e sqaruara janë dy: Pozicioni 6. Porosia, furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit lineare 9m, çmimi l ofertuar 1ë/copë</p> <p>Përgjigja e OE të propozuar për kontratë janë disa fotografi të shtyllave të betonit që nuk kan të bëjnë fjalë me permasat teknike të shtyllave të kërkuara.</p> <p>Megjithatë OE nuk ka ofruar asnjë përgjigje bindëse rreth ekonomisë së procesit, pasi një gjë e tillë është e pamundur të arsyetohet në raport me çmimin e</p>
---	--	---

		<p>ofertuar, pasi që raporti në mes çmimit të prodhimit dhe çmimit të ofertimit është 80/1*100=8, 000.00%.</p> <p>Përveç se një deklaratë të një distributor (jo prodhues) se kinse do ju qëndroj mbrrapa çmimeve të ofruara më herë? Atëher për cilat çmime bëhet fjalë?</p> <p>dhe Pozicionet: 24. Furnizimi, transporti dhe montim i shtyllës ndriquese të zingtuar konike që realizohet me mbjellje me lartësi H =7.8m me pjesë reduktuese në shtyllë duke përfshirë ,kapakun, kabëll lidhëse (3x2.50mm²) dhe materialit tjetër të nevojshëm.Komplet me standarde ISO.</p> <p>UNI EN ISO 1461 standardi i zingtimit, 1€/copë dhe</p> <p>Pozicioni: 28. Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllës ndriquese të zingtuar konike që realizohet me mbjellje me lartësi H =5.5m me pjesë reduktuese në shtyllë duke përfshirë , kapakun, kabëll lidhëse (3x2.50mm²) dhe materialit tjetër të nevojshëm.Komplet me standarde ISO.</p> <p>UNI EN ISO 1461 standardi i zingtimit, 1€/copë</p> <p>Përgjegjja e OE të propozuar për kontratë janë disa fotografi të shtyllave të metalta që nuk kanë të bëjnë fare me përmasat teknike të shtyllave të kërkuara. Megjithatë OE nuk ka ofruar asnjë përgjegjësi bindëse rreth ekonomisë së procesit, pasi që raporti në mes çmimit të prodhimit dhe çmimit të ofertimit është 120/1*100=120, 000.00%. Përveç se një deklaratë të një distributor (jo prodhues) se kinse do ju qëndroj mbrrapa çmimeve të ofruara me herë? Atëher për cilat çmime bëhet fjalë?</p>	
--	--	---	--

Grupi I Operatorve ekonomik: N.N.P. NDRIÇIMI; N.T.SH. INLINE ENGINEERING	Arsyetimet e OE nuk kan qenë bindëse, prandaj AK e ka eliminuar.	Sçarime për pozicionet: 2, 10, 23, 35,44 dhe 45. Ne mendojmë se përveç këtyre pozicioneve në paramas dhe parallogari ka edhe më shumë pozicione të cilat janë jo-normalisht të ulëta dhe të cilat është dasht të trajtohen sit ë tilla.	
NITI-N SH.P.K.	Arsyetimet e OE nuk kan qenë bindëse, prandaj AK e ka eliminuar.	Sçarime për pozicionet: 2, 10, 23, 35, 44, dhe 45. Ne mendojmë se përveç këtyre pozicioneve në paramas dhe parallogari ka edhe më shumë pozicione të cilat janë jo-normalisht të ulëta dhe të cilat është dasht të trajtohen sit ë tilla.	
Grupi I Operatorve ekonomik: MONTING SH.P.K. AND LIGHT AND MORE	Nuk ka kthyer përgjigje në pyetjet e AK,, prandaj AK e ka eliminuar.	Nuk janë evidentuar pyetjet që ju ka dërguar AK, mirëpo nuk kan kthyer përgjigje brenda afatit kohor.	

• PËRFUNDIMI/KONKLUZIMI

Duke ju referuar të gjitha këtyre që u than e u shtjelluan me lartë, atëher për këtë aktivitet të prokurimit AK i ka shkeluar të gjitha dispozitat ligjore të listuara në pjesën e "6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues" dhe të argumentuara në pjesën e "7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet".

Pas analizës së bër, të gjeturave, fakteve dhe argumenteve të dëshmuara dhe të evidentuara, atëher AK duhet ta kthejë këtë aktivitet të prokurimit në rivlersim. Ndërsa për dokumentet e gjetura të falsifikuara dhe mashtrimet tjera me dokumente zyrtare, AK të marr masa konform ligjeve përkatëse në fuqi, kur për të njëjtit jan faktuar dëshmi dokumentare për kryerjen e veprave të jashtligjshme dhe që dëmtojnë konkurrencen e barabart si dhe cilësin e realizimit të punimeve. Këto dokumente është dashtë të verifikohen dhe evidentohen nga komisioni i vlerësimit. Nga ajo që kemi pa, komisioni i vlerësimit ka qenë joprofesional, inxhinier te Elektros nuk ka pas fare.

Pas të gjitha këtyre të gjeturave, AK ka kthyer përgjegje ne kërkesen për rishqyrtim dhe te njejten e ka refuzuar.

Prandaj lusim OSHP që ta shqyrtojë në përpikri ankesën a parashtruar me komision profesional conform LPF dhe legjislacionit sekondare si dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit ne rivlersim

Me respekt,

"RISAMONT" SH.P.K.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkakuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:



Demet financiare qe na jan shkaktuar nga keto shkelje ligjore, perafersisht jane
rreth 100,000.00Euro

9. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjithi Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektit.
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektit" apo "Njoftimit për Anullim".
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshem/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informata të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

^{**}Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.



Dëmet Materiale

Dëmet financiare që na janë shkaktuar nga këto shkelje ligjore, përafërsisht janë rreth 100,000.00€.

Shënim: Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar nga OE ankuese në OSHP, janë të njëjta me ato të paraqitura me kërkesën për rishqyrtim nga OE ankuese në AK

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	11.04.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë publike -kornizë/vlerë e madhe
Vlera e parashikuar e kontratës	300,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	03.05.2019
Data e hapjes së ofertave	03.05.2018
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave	30.05.2018
Data e njoftimit me letrën standarde	30.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	05.06.2018
Data e vendimit nga AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim	05.06.2019

Kriteret për vlerësim:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Ndriqimi" -Prishtinë, dhe ankesën e parashtruar nga OE "Risamont"-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik", me numër të prokurimit.616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

Çmimi më i ulët.

Qëllimi i Kontratës	2.1	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 45000000-7 Qëllimi i kontratës është ekzekutimi i punëve ne vijim: <i>[shëno përshkrimin e përgjithshëm të punëve]</i> Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik Specifikimin teknik e gjeni në dosje të tenderit.		
Vlera e parashikuar	2.4	300.000,00 €		
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.1	Vendi i ekzekutimit te punëve është: Komuna e Prishtinës - Prishtinë		
	5.2	Afatet kohore për fillimindhe/osepërfundiminekontratës: 12 muaj		
<u>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik</u>	6.4	<p>Përveç deklaratës se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet</p> <p>Dokumentet te cilat do te kërkojnë si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërisë janë me se vijon:</p> <p>a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative tëvendit të tenderuesit.</p> <p>b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë tillë nuk ekziston.</p> <p>c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit <i>[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]</i></p> <p>Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.</p>		
		<table><tr><td>Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net</td><td>Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes së Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonësë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para</td></tr></table>	Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes së Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonësë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para
Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes së Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonësë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para			

		<p>dorëzimit të tenderit.- kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata - kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet të kërkuara në piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdojë me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhë.</p>	
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<p>Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>1. Kopja e Certifikatës së biznesit</p>
		<p>2. Certifikata e numrit fiskal</p>	<p>2. Kjoja e Certifikatës së numrit fiskal</p>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 500.000,00 €</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>1. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur</p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p>Kapaciteti teknik dhe profesional:</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare</p>

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, ne vlere minimale prej 300.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit 2016-2017-2018 (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).

2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) Një inxhinier të Elektroteknikës - me përvojë 3 vjeçare pas diplomimit. b) 10 (dhjetë) punëtor me përvojë në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit për ndriçimin publik

3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. a) 2 (dy) Kamion me SHPORTA b) 1 (nje) Kamion me Vinç c) 1 (nje) Eskavator

4. Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj Certifikatën CE për kualitetin e dritave dhe Certifikatën ISO STANDARD 9001 2015 për Menxhim.

1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt (Inxhinierin e elektroteknikës). Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt për (10 punëtorët).

3. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen për vitin 2019. Ne rastet kur OE ka marreveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.

Certifikate CE dhe Certifikata ISO STANDARD 9001 2015 me validitet 2019

		5. Operatori Ekonomik duhet ta sjell KATALOGUN për shtylla dhe drita 6. Operatori duhet ta sjell autorizimin nga prodhuesi i licencuar 7. Operatori ekonomik duhet ti sjell mostrat në datën e hapjes së ofertave	Katalogu duhet të jetë origjinal Autorizimin origjinal nga prodhuesi Mostrat e trupave ndriçues 50Ë, 100Ë, 150Ë.
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët , duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	
Nënkontraktimet	12.1	a. një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b. Të gjithë kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.	
Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po <input checked="" type="checkbox"/> Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.	
	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit 6000 € Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 150 apo muaj	
Siguria e ekzekutimit	14.1	Siguria e kërkuar e ekzekutimit: Po <input checked="" type="checkbox"/> Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.	
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % e vlerës së përgjithshme të kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 muaj	
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	12.04.2019	
Dokumentet që përbejnë Tenderin	19.1(h)	<i>[Nëse është e aplikueshme shëno kërkesat tjera]</i>	
Periudha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 120 Ditë	
Afati i fundit idorëzimit të	23.1	Afati i fundit për dorëzim është je 03.05.2019 14:00:00 Vendi: Ofertat dorëzohet në mënyrë elektronike përmes platformës E-Prokurimit.	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Ndriçimi"-Prishtinë, dhe ankesën e parashtruar nga OE:"Risamont"-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik", me numër të prokurimit: 616-19-2038-S-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

tenderit		Mostrat dorëzohen me datën e hapjes së ofertave në mënyrë fizike në Departamentin e Prokurimit.
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do të bëhet me 03.05.2019 14:00:00 Vendi: Komuna e Prishtinës - Departamenti i Prokurimit - Kati i dytë, zyra nr.220
Kriteret e Dhënies	30.1	[Tenderi i përgjegjshëm Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët i poentuar <input checked="" type="checkbox"/>
Ankesat	31.3	https://kk.rks-gov.net/prishtine/ - Komuna e Prishtinës

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznakaponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (ëith VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshim lotësimi Suplement Amendme Dpuna/Izn ena
RISAMONT SH.P.K., Kroi I Bardhe, 10 000, Prishtinë	05/2019	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	719,07	848,50	JO
Grupi i Operatoreve N.N.P. NDRIQIMI ; N.T.SH. INLINE ENGINEERING, Lot Vaku, 10000, Prishtinë	03	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	633,45	747,48	JO
" BM GROUP " SH.P.K., VETERNIK, 10000, PRISHTINË	BM-03-05	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	837,08	987,75	JO
Termomontimi shpk, Zona Industriale, 10000, Prishtine	616-19-2038-5-2-1	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	1260,17	1487,00	JO
Multi Business Group SH.P.K., JUSUF GËRVALLA 103 K.II, -, PRIZREN	XIXIX	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	55322,00	65280,00	JO
NITI - N SH.P.K., ULPIANA A1-LOK-2A, -, PRISHTINË	006/2019	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	676,58	798,37	JO
Grupi i Operatoreve MONTING SH.P.K.; LIGHT AND MORE SH.P.K., Bulevardi Bill Clinton Lakrishte Sol 1 Lok 3, 10000, Prishtinë	3/19	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	948,94	948,94	JO
Grupi i Operatoreve N.SH. M.V.R.ELEKTROMONTUES ; Delta -Ing SH.P.K., PRISHTINE, -, HAJVALI	oferta mvr 1	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik	PO	141,61	167,10	JO

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OF Ndriçimi" -Prishtinë, dhe ankesën e parashtruar nga OE:"Risamont"-Prishtinëlidhur me aktivitetin e prokurimit"Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik", me numër të prokurimit:616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për rivlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

Flamur Sallahu– Kryetar i komisionit

Ibrahim Morina– Anëtar i komisionit

Afrim Gashi – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Grupi i OE-ve “Ndriqimi” dhe “Inline Engineering”, arsyet e eliminimit për shkak të çmimit jo normalisht të ulët:

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtines me datë: 27.05.2019, ka kërkuar sqarim për çmim abnormalisht të ulët në pozicionet: ? Pozicioni 2: (Furnizimi ,transporti dhe montimi i trupit ndriçues LED me kënd

të rregullimit me këto karakteristika:

Fuqia: 100Ë LED , 1 LED=1Ë; Temperatura e ngjyrave:5500K; Eficienca e dritës:130 lm/Ë; Qip LED referimi:CREE,EPISTAR,BRIDGELUX.

Garancioni-3 vite.

Vërejtje:

Fuqia e trupit ndriçues duhet të jetë 100Ë dhe 1LED=1Ë).

? Pozicioni 10: Furnizimi ,transporti dhe montimi e përçuesit i ndriç ,Publik 2 x 16 mm2- X00-A, të llogaritur për m’

? Pozicioni 23: Porosia dhe shtrirja e kabllos nëntokësore PP 41 ose PP OO 4x35 mm2 Al prej TS 10/0,4 kV gjer në ormanin e grupit matës.

? Pozicioni 35: Furnizimi ,transporti dhe shtrirja e kabllos nëntokësorë i TIP-it PP 00 4x16mm2 Al në kanal të hapur ku në çmim duhet të llogariten materialet tjera të nevojshme për çdo shtyllë veç e veç deri në kyqje në ormanin e ndriçimit publik.

? Pozicioni 44: Identifikimi i prishjes së kabllos me makinë speciale.

? Pozicioni 45: Porosia dhe montimi i vazhduesve kabllovik (muf) me dim. 50, 25, dhe 16mm2

Operatori Ekonomik nuk ka dhene sqarimet e detajuara dhe te argumentuara me prova faktike te kerkuara andaj Komisioni i vleresimit vendos per eliminimin e ofertes se ketij operatori.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Ndriqimi"-Prishtinë

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë i OE "Ndriqimi" ka të bëjë me arsyen e eliminimit të këtij OE nga ana e AK-së. AK-KK Prishtinë e ka eliminuar OE "Ndriqimi" me arsyetim se i njëjti ka ofruar cmime jo normalisht të ulëta. Duhet theksuar se OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka një numër të pozicioneve me cmime jo normalisht të ulëta, ashtu siq pretendon OE ankues Ndriqimi, me gjithë atë për dallim nga OE ankues i cili është eliminuar mbi këtë bazë, OE tjetër është rekomanduar për dhënie të kontratës, pra AK gjatë vlerësimit të ofertave për të njëjtën çështje ka bërë vlerësim të ndryshe për dy OE të ndryshëm.

Sipas nenit 7 par.1 të LPP-së "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", në rastin konkret rregullat për cmime jo normalisht të ulëta duhet të zbatohen për të gjithë OE-të njësoj, do thotë nëse AK e sheh të arsyeshme të kërkoj sqarime për cmim jo normalisht të ulët **për pozicione**, atëher të këtë duhet zbatoj për të gjithë OE-të pa dallim.

Duke u bazuar në ato që u cekën më lart, eksperti shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimorë është pjesërisht i bazuar dhe se AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 7 par.1 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Risamont" -Prishtinë

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimet ankimore të OE Risamont fillimisht kanë të bëjnë me dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, konkretisht raportet e pranimit dhe referencat për një numër të kontratave të këtij OE.

OE ankues shpreh dyshim për falsifikim të dokumenteve nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, kjo për arsye se për një numër të kontratave sipas OE ankues, OE i rekomanduar ka ofruar : raporte të pranimit pa vulë, ka ofruar referenca për kontrata të cilat janë paraparë të përfundojnë në fund të vitit 2019, ka ofruar raporte ku numri i prokurimit dallon me numërin e prokurimit të shënuar në kontratë dhe ku numri në kontratë duket të jetë përmirësuar, se OE ka dorëzuar kontrata të vitit 2015 që i bie jashtë periudhës së kërkuar për tri vitet e fundit etj.

Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimet ankimore për falsifikim, eksperti shqyrtues nuk ka kompetencë të jap konstatim në pretendime të tilla, me gjithë duke u bazuar në arsyet e dhëna nga OE ankues, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që në rast të kthimit të lëndës në rivlerësm, të obligohet AK të konfirmoj vërtetësinë e këtyre kontratave të kontestuara nga OE ankues. Kjo mud të vërtetohet duke kërkuar konfirmim me shkrim nga autoritetet kontraktuese nëse këto kontrata vërtet janë realizuar me vlerë dhe datë ashtu siq janë shënuar në listën e OE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimit ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar kontrata të lidhura me kompani private për të cilat nuk ka ofruar dëshmi –transaksione banakre, sipas LPP-së në raste të tilla AK duhet të kërkojnë dëshmi nga banka për realizimin e këtyre kontratave, mirëpo në rastin konkret kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit andaj nuk mundet të përdoret si arsye për eliminim të OE.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar katalog për shtylla të betonit, sipas dokumentacionit të gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në platformën “E-Prokurimi”, nuk kam hasur në dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalog për shtylla të betonit, andaj vlerësoj se ky pretendim ankimorë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Sa i përket pretendimit ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për “Eskavator”, sipas dokumentacionit të gjetur një platformën “E Prokurimi” OE ka ofruar Kontratë për Qiramarrje me kompaninë Delta Ing për eskavator tipi “SKIP JCB”, si dhe dudin doganor ne emwr tw kompanisw Delta Ing pwr pajisjen Modeli-JCB, tipi - 4CX, andaj vlerësojmë se ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Sa i përket pretendimit ankimorë lidhur me stafin, OE ankues pretendon se nuk janë ofruar 10 punëtor profesional në ndriqim.

Duhet sqaruar se kërkesë e dosjes ka qenë 10 punëtor “**me përvojë në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit për ndriçimin publik**”, dhe jo dhe 10 punëtor “**profesional në ndriqim**”.

Kërkesa e AK-së “me përvojë” është shumë e përgjithshme dhe në rastin konkret nuk mundet të objektivisht të

konstatohet që punëtorët fizik nuk kanë përvojë në projekte të tilla.

Andaj përderisa nuk ka kërkesë decidive apo kërkesë për dëshmi mbi përvojën të këtyre punëtorëve, eksperti shqyrtues konsideron se kjo nuk mund të jetë arsye për eliminim të OE në fjalë dhe ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit, sipas dokumentacionit të gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në platformën E-Prokurimit, në ofertën e këtij OE gjendet lista me projekte të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE.

Për dallim nga aneksi 6 dosjes së tenderit, listës së ofruar nga OE i mungon paragrafi në fund të listës ku shënon:

“Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohej nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomi”.

Me qenë se lista e OE përmban të gjitha të dhënat tjera të kërkuara me aneksin 6, si dhe nënshkrimin dhe vulën e OE, si dhe faktin se OE ka dhënë edhe deklaratën nën betim, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo listë është pranueshme.

Përgjigje në Pretendimi nr.7

Lidhur me pretendimet ankimorë për cmime jo normalisht të ulëta, është e vërtetë se disa OE për disa pozicione kanë ofruar cmime që duken të jenë jo normalisht të ulëta. Eksperti shqyrtues sqaron ashtu siq kemi potencuar më lartë në përgjigje të pretendimeve ankimorë të OE “Ndriqimi”, se OE i rekomanduar për kontratë, ashtu edhe OE të tjerë për disa pozicione duket të kenë ofruar cmime jo normalisht të ulëta, mirëpo sipas nenit 61 pika 6 të LPP-së, mënyra për trajtimin e cmimeve jo normalisht të ulëta është akti nënligjorë i nxjerr nga KRPP, në rastin konkret rregullat për cmime jo normalisht të ulëta B57.

Këto rregulla duhet të zbatohen për të gjithë OE-të njësoj ku sipas nenit 4.2 të këtyre rregullave citoj:

*“4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkoj me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja”.*

Përveq kësaj pas sqarimeve të dhëna nga OE, autoriteti kontraktues sipas nenit 4.4 të këtyre rregullave duhet që :

4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

4.4.1 ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

4.4.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

4.4.3 **çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose**

4.4.4 origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimorë është pjesërisht i bazuar dhe nëse AK ka dyshime në cmimet e ofruara nga OE-të atëherë këtë problem duhet ta trajtoj sipas dispozitave ligjore nga neni 61.6 lidhur me rregullat për cmim jo normalisht të ulët, për të gjithë OE-të njësoj dhe se sqarimet e dhëna nga OE-të duhet të jenë bindëse për AK-në në pajtim me nenin 4 të rregullave për cmim jo normalisht të ulët.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të **aprovhen si pjesërisht të bazuara** (për arsyet që u ceken tek përgjigjjet në pretendimet ankimore), ndërsarekomandon që anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.